



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

Në mbështetje të nenit 29 pikat 5 e 8 të ligjit 10019 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 10 të udhëzimit nr. 2 datë 5 dhjetor 2020 “Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në Komisionet e Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Komisionet e Qendrave të Votimit”, KQZ pranon aplikime nga shtetas që mund të emërohen kryesisht në Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) nga KZAZ në rast të mosplotësimit të numrit të nevojshëm të anëtarëve të KQV për vendimmarrje. Aplikimet bëhen në linkun <http://bit.ly/3Tc2vQ5> ose të dërguara në adresën postare të KQZ-së, Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4, Tiranë.

AFATI PËR TË APLIKUAR: 14.04.2023

KUSHTET PËR EMËRIMIN KRYESISHT TË ANËTARIT DHE SEKRETARIT TË KQV-SË

1. Anëtar dhe Sekretar i KQV-së mund të emërohet kryesisht nga KZAZ çdo shtetas që plotëson kushtet e mëposhtme:
 - a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
 - b) ka të paktën arsimin e mesëm;
 - c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
 - ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - d) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;
 - dh) nuk ka qënë anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike tre vitet e fundit;
2. Sekretari i KQV-së, si rregull ka arsimin e lartë.

PAPAJTUESHMËRITË ME DETYRËN E ANËTARIT DHE TË SEKRETARIT TË KQV-SË

Nuk mund të shprehin interes dhe as të emërohen kryesisht anëtarë dhe/ose sekretarë të KQV-së shtetasit që janë:

- a) deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
- b) kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
- c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;
- ç) anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin shtetasit:

- a) Kërkesë për shprehje interesi për emërimin kryesisht si anëtar apo si sekretar i KQV-së, duke përcaktuar numrin e Zonës Zgjedhore dhe numri i ZAZ-së ku kanë vendbanimin. Kërkesa paraqitet e nënshkruar, dhe përfshin adresën e postës elektronike dhe numrin telefonik të kontaktit;
- b) Çertifikatë personale të lëshuar nga zyra e gjendjes civile apo nga portali e-albania;
- c) Kopje të noterizuar të diplomës të nivelit më të lartë të arsimit të kryer;
- ç) Deklarim të nënshkruar nga shtetasi, sipas lidhjes KQZ-04-22 bashkëlidhur, se:
- Tre vitet e fundit nuk ka qënë pjesë e strukturave drejtuese të asnjë partie politike;
 - Pesë vitet e fundit nuk ka patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor;
 - Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - Ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore;
 - Shprehja e interesit për emërim kryesisht në përbërje të KQV-së nuk shkon për mbështetje të asnjë partie politike/subjekti zgjedhor;
 - Nuk ka marrdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë zgjedhore për organet e qeverisjes vendore;
 - Nuk është në marrdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë;